EDUCATION IN NORTH MACEDONIA FACING CONTEMPORARY CHALLENGES: RESULTS, PROBLEMS AND RECOMMENDATIONS FOR IMPROVEMENT

ARSIMI NË MAQEDONINË E VERIUT PËRBALLË SFIDAVE BASHKËKOHORE: REZULTATET, PROBLEMATIKAT DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIM

Farketa DIBRA-ZEQIRI[1], Hana DARDHISHTA[2]

[1*]*Department of Albanian Language and Literature, "Blaze Koneski" Faculty of Philology, Ss. Cyril and Methodius University in Skopje*
[2] *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*
[*]*Corresponding author e-mail: farketadibra@gmail.com; hana.dardhishta@unite.edu.mk*

Abstract

This study examined the state of the education system in North Macedonia and the main challenges faced by education in adapting to contemporary requirements. The aim of the study was to identify the problems affecting the quality of the teaching process, to assess the implementation of contemporary teaching approaches, and to identify opportunities for improving educational practices. The research was conducted during the period from March to May 2025 and involved 320 primary and secondary school teachers from urban and rural schools in Kumanovo, Skopje, Tetovo, Gostivar, Kičevo, Debar, and Struga. A 10-item questionnaire was used as the data collection instrument, while the data were analyzed using statistical and content analysis methods. The results showed that traditional teaching practices remained prevalent in a considerable number of schools, while the use of technology and the implementation of contemporary teaching approaches remained limited. Teachers identified the lack of infrastructure and equipment, limited opportunities for professional development, inadequate functioning of professional subject teams, the misalignment of some textbooks with curriculum requirements, the politicization of the education system, and the impact of depopulation as major obstacles. The results also indicated the need for changes in student assessment practices and for the development of reading comprehension, critical thinking, and problem-solving skills. In conclusion, the study emphasized the need for sustainable educational reforms, continuous professional development of teachers, improved infrastructure and working conditions, and stronger professionalism and merit-based practices within the education system.

Keywords: contemporary education; quality of education; contemporary teaching; education policies; professional development.

Abstrakt

Ky studim trajtoi gjendjen e sistemit arsimor në Maqedoninë e Veriut dhe sfidat kryesore me të cilat përballej arsimi në procesin e përshtatjes me kërkesat bashkëkohore. Qëllimi i hulumtimit ishte të identifikoheshin problematikat që ndikonin në cilësinë e procesit mësimor, të vlerësohej zbatimi i qasjeve bashkëkohore të mësimdhënies dhe të evidentoheshin mundësitë për përmirësimin e praktikave arsimore. Hulumtimi u realizua gjatë periudhës mars–maj 2025, me pjesëmarrjen e 320 mësimdhënësve të ciklit fillor dhe të mesëm nga shkolla urbane dhe rurale të Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës dhe Strugës. Si instrument për mbledhjen e të dhënave u përdor një pyetësor me 10 pyetje, ndërsa të dhënat u analizuan përmes metodave statistikore dhe përmbajtësore. Rezultatet treguan se mësimdhënia tradicionale vazhdonte të ishte e pranishme në një pjesë të konsiderueshme të shkollave, ndërsa përdorimi i teknologjisë dhe zbatimi i qasjeve bashkëkohore mbeteshin të kufizuara. Mësimdhënësit evidentuan si pengesa kryesore mungesën e infrastrukturës dhe pajisjeve, mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional, funksionimin jo të kënaqshëm të aktiveve profesionale, mospërputhjen e disa teksteve me kërkesat e kurrikulës, politizimin e sistemit dhe ndikimin e shpopullimit. Rezultatet treguan gjithashtu nevojën për ndryshime në mënyrën e vlerësimit dhe për zhvillimin e kompetencave të leximit me kuptim, të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve. Në përfundim, studimi theksoi nevojën për reforma të qëndrueshme, zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve, përmirësim të kushteve infrastrukturore dhe forcim të profesionalizmit dhe meritokracisë në sistemin arsimor.

***Fjalë kyçe**:* arsimi bashkëkohor, cilësia e arsimit, mësimdhënia bashkëkohore, politikat arsimore, zhvillimi profesional.

1. Hyrje

Fati dhe prestigji i një shteti varen drejtpërdrejt nga gjendja e sistemit arsimor. Një sistem arsimor i qëndrueshëm dhe cilësor pa dyshim do të reflektojë në ngritjen dhe zhvillimin e vlerave ekonomike, politike e shoqërore të një shteti. Nuk ka mëdyshje se arsimi është çelësi dhe shtylla e një shoqërie të shëndoshë, andaj ne, si popull, duhet të luftojmë për ta mbajtur të palëkundur e të fortë këtë shtyllë nga furitë e shumta dhe të njëpasnjëshme, që e rrezikojnë lëkundjen e kësaj shtylle.

Për fat të keq, në vendin tonë sistemi arsimor lëkundet sa herë që ndryshojnë ministrat dhe partitë politike që udhëheqin shtetin. Nëse u referohemi dy dekadave të fundit, do të vërejmë se arsimi është përballur me reforma të mëdha duke filluar nga projekti "Një nxënës një kompjuter", "Vlerësimi ekstern", "Matura shtetërore", "Ditari elektronik", "Puna në grupe të vogla", "Digjitalizimi në arsim", etj. Në këto reforma përfshihen edhe tekstet shkollore të përshtatura nga jashtë sipas programeve mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) te përkthyera në gjuhët në të cilat realizohej mësimi në vendin tonë (Dardhishta, 2023: 263). Thelbi i këtyre reformave ishte dhe mbetet "përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe përqendrimi te të nxënit me kuptim, në vend të memorizimit të të dhënave". Boshti i gjithë këtyre reformave sillej rreth nxënësit. Kujtojmë se në asnjë rast nuk u mbajt llogari për punën e mësimdhënësit, si do ta përballojë ai gjithë këtë ndryshim, kalimin e sistemit nga modeli tradicional i mësimdhënies në modelin bashkëkohor (Dibra Zeqiri, 2024 : 121).

Si rrjedhojë e kësaj situate, sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut vazhdon të përballet me sfida të rëndësishme, të cilat reflektohen edhe në rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare të nxënësve. Një nga treguesit më të rëndësishëm në këtë drejtim janë rezultatet e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), i cili vlerëson aftësinë e nxënësve 15-vjeçarë për t'i zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në situata të ndryshme dhe në kontekste të jetës reale.

Rezultatet e PISA-s ndër vite tregojnë se vështirësitë në fushën e leximit me kuptim, por edhe në fusha të tjera, vazhdojnë të jenë të pranishme te nxënësit në Maqedoninë e Veriut. Në vlerësimin PISA 2018 u evidentuan vështirësi të konsiderueshme në leximin me kuptim, duke treguar se një pjesë e nxënësve hasnin vështirësi në përpunimin dhe përdorimin e informacionit të marrë nga tekstet. Në vlerësimin PISA-s 2022, këto vështirësi vazhduan të shfaqeshin, duke dëshmuar se përmirësimi i performancës në leximin me kuptim mbetet një sfidë e rëndësishme për sistemin arsimor (OECD, 2023). Rezultatet më të fundit, nga PISA 2025, të publikuara më 8 shtator 2026, e bëjnë edhe më të qartë këtë problematikë. Në fushën e leximit, nxënësit e Maqedonisë së Veriut arritën mesatarisht 357 pikë, ndërsa mesatarja e vendeve të OECD-së ishte 461 pikë. Gjithashtu, vetëm 26% e nxënësve arritën të paktën Nivelin 2 të kompetencës në lexim, krahasuar me 69% në vendet e OECD-së (OECD, 2026).

Krahasimi i rezultateve të PISA-s 2018, PISA-s 2022 dhe PISA-s 2025 tregon se vështirësitë në lexim nuk përbëjnë një problem të izoluar të një cikli të vetëm vlerësimi, por një sfidë të vazhdueshme që kërkon vëmendje të veçantë. Vështirësitë e nxënësve shtrihen përtej të kuptuarit bazë të një teksti dhe lidhen edhe me aftësi më të avancuara të leximit funksional, si identifikimi dhe interpretimi i informacionit, reflektimi mbi përmbajtjen dhe vlerësimi i informacionit të marrë nga burime të ndryshme.


Në këtë hulli, rezultatet e PISA-s duhet të shërbejnë si pikë referimi për vlerësimin e efektivitetit të praktikave mësimore dhe të politikave arsimore. Mungesa e përmirësimit të dukshëm në rezultatet e leximit e bën të nevojshëm rishikimin e programeve mësimore, qasjeve

metodike dhe formave të vlerësimit, me synim kalimin nga një model i përqendruar kryesisht në transmetimin dhe riprodhimin e njohurive drejt një modeli bashkëkohor, i cili zhvillon kompetencat, të menduarit analitik e kritik dhe aftësinë për zbatimin e njohurive në situata të ndryshme.
Në këtë kontekst, rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare PISA paraqesin një tregues të rëndësishëm për gjendjen e sistemit arsimor, por ato nuk mund të shpjegojnë në mënyrë të plotë faktorët që ndikojnë në procesin e përditshëm mësimor. Për këtë arsye, për të evidentuar më nga afër sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit, nxënësit dhe shkollat në Maqedoninë e Veriut, në kuadër të këtij studimi, kemi realizuar një hulumtim empirik, i cili synon të identifikojë problematikat kryesore të procesit mësimor dhe të evidentojë qasjet që mund të kontribuojnë në bashkëkohësimin e arsimit.

2. Instrumentet dhe metodat e hulumtimit

Për realizimin e hulumtimit kemi përdorur metodën e anketimit, ndërsa si instrument për mbledhjen e të dhënave kemi përgatitur një pyetësor të përbërë nga 10 pyetje. Pyetësori përfshin pyetje me alternativa dhe pyetje të hapura, duke u dhënë mundësi mësimdhënësve të shprehin mendimet, vlerësimet, gjykimet, komentet dhe rekomandimet e tyre lidhur me problematikat që hasin gjatë realizimit të procesit mësimor.
Kampioni i hulumtimit përbëhet nga 320 mësimdhënës të ciklit fillor dhe të mesëm, përkatësisht nga klasat I–XII. Në hulumtim janë përfshirë mësimdhënës nga shkollat urbane dhe rurale të Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës dhe Strugës. Përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë në mënyrë të rastësishme. Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës mars–maj 2025. Për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave kemi përdorur metodën induktive-deduktive, metodën e analizës teorike, metodën e sintezës, metodën e anketës, metodën përshkruese dhe statistikore. Të dhënat e vjela nga pyetësori i janë nënshtruar analizës statistikore dhe përmbajtësore. Analiza statistikore ka mundësuar përpunimin dhe paraqitjen e të dhënave në mënyrë të strukturuar dhe me përqindje, ndërsa analiza përmbajtjesore është përdorur për sistemimin dhe interpretimin e përgjigjeve ndaj pyetjeve të hapura. Gjetjet e nxjerra nga analiza kanë shërbyer si bazë për interpretimin e rezultateve, nxjerrjen e përfundimeve dhe formulimin e rekomandimeve.

3. Rezultatet dhe interpretimi i të dhënave



Rezultatet e pyetjes së parë tregojnë se 30% e mësimdhënësve në shkollat tona e realizojnë orën mësimore në mënyrë tradicionale, ndërsa 29% zbatojnë qasje bashkëkohore, duke përdorur TIK-un, teknika dhe strategji të ndryshme mësimore. Përqindja më e lartë, 41%, i përket mësimdhënësve që kombinojnë mënyrën tradicionale me atë bashkëkohore të mësimdhënies.

Nga këndvështrimi i kërkesave të arsimit bashkëkohor, mbështetja e tepruar në mësimdhënien tradicionale mund të ndikojë në pasivizimin e nxënësit dhe në krijimin e një atmosfere monotone gjatë procesit mësimor. Një qasje e tillë shpesh karakterizohet nga transmetimi i njohurive të gatshme, përqendrimi në përsëritjen e informacionit dhe roli dominues i mësimdhënësit. Në këtë mënyrë, nxënësi rrezikon të mbetet më shumë pranues i informacionit sesa pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e njohurive.
Orë më të suksesshme të mësimit janë ato që i nxisin nxënësit të mendojnë vetë dhe të përfshihen në të menduarit kritik (Temple et al., 2006, f. 4) Për këtë arsye, në arsimin bashkëkohor gjithnjë e më shumë synohet kalimi nga mësimdhënia e përqendruar te mësimdhënësi drejt një procesi ku nxënësi vendoset në qendër të të nxënit. Në vend që të marrë dhe të memorizojë njohuri të gatshme, nxënësi duhet të angazhohet në mënyrë aktive në procesin e të nxënit, të kuptojë dhe të zbatojë njohuritë e fituara dhe të zhvillojë aftësi të të menduarit të nivelit të lartë. Ajo që synohet përmes zbatimit të metodave, teknikave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies është që mësimdhënësi të jetë në gjendje të dallojë *jo vetëm atë që di, por edhe atë që është në gjendje të bëjë nxënësi me njohuritë e fituara* (Gjokutaj, 2009 : 262). *Në këtë kuptim, procesi mësimor nuk kufizohet vetëm në përvetësimin e informacionit, por synon aktivizimin e të menduarit dhe përdorimin funksional të njohurive për arritjen e standardeve të përcaktuara më parë* (Orlich et al., 1995 :10).
Megjithatë, rezultatet e pyetjes në fjalë tregojnë se mësimdhënia bashkëkohore ende nuk është bërë praktikë dominuese në shkollat tona. Fakti që vetëm 29% e mësimdhënësve deklarojnë se e realizojnë mësimin në mënyrë bashkëkohore, ndërsa 30% vazhdojnë të mbështeten në mënyrën tradicionale dhe 41% i kombinojnë të dyja qasjet, tregon se procesi i transformimit të praktikave mësimore është ende në zhvillim. Kjo gjendje sugjeron nevojën për forcimin e praktikave që nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, përdorimin e strategjive të larmishme dhe kalimin nga një model i bazuar kryesisht në transmetimin e njohurive drejt një modeli që e zhvillon nxënësin si pjesëmarrës aktiv në procesin e të nxënit. Siç thekson Zwiers, (2005 : 40) *mësimdhënie e suksesshme do të thotë të krijosh një mjedis ku nxënësit të përfshihen, të përballen me sfida të ndryshme dhe të zhyten në lloje të ndryshme të të menduarit pa u mbingarkuar*.


- **Cilët faktorë e vështirësojnë realizimin e orës mësimore sipas qasjes bashkëkohore të mësimdhënies?**

Meqenëse kjo ishte një pyetje e hapur, mësimdhënësve u dha mundësia të shprehnin lirshëm mendimet e tyre lidhur me vështirësitë dhe pengesat që hasin gjatë zbatimit të qasjeve bashkëkohore në mësimdhënie. Analiza e përgjigjeve tregoi se vështirësitë lidhen me disa kategori kryesore, të cilat mund të përmblidhen si më poshtë:


- Kushtet dhe infrastruktura teknologjike – qasja e kufizuar ose mungesa e internetit për shkak të cilësisë së dobët të rrjetit në shkollë, si dhe mungesa e kompjuterëve dhe tabelave të mençura në të gjitha klasat.
- Mungesa e pajisjeve didaktike – numri i pamjaftueshëm i projektorëve, ku në disa raste në dispozicion të gjithë shkollës është vetëm një projektor.
- Mungesa e kabineteve dhe laboratorëve – pamjaftueshmëria e hapësirave të specializuara për realizimin e aktiviteteve praktike dhe mësimit të bazuar në përvojë.
- Pamjaftueshmëria e materialeve dhe mjeteve të punës – mungesa e printerëve, letrës dhe materialeve të tjera didaktike, të cilat në shumë raste mësimdhënësit duhet t'i sigurojnë me shpenzime personale.

- Mundësitë e kufizuara për zhvillim profesional – mungesa e trajnimeve të mjaftueshme për përvetësimin dhe zbatimin praktik të teknikave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies.
- Motivimi i pamjaftueshëm i nxënësve për përfshirje aktive në procesin mësimor.
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm profesional ndërmjet mësimdhënësve dhe aktiveve profesionale, veçanërisht në drejtim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të suksesshme;
- Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me prindërit, i cili mund të ndikojë në mbështetjen e procesit mësimor.
- Faktorët socio-ekonomikë, të cilët gjithashtu u identifikuan si një nga pengesat për zbatimin e qasjeve bashkëkohore në mësimdhënie.


Përgjigjet e mësimdhënësve tregojnë se vështirësitë nuk lidhen vetëm me gatishmërinë individuale të mësimdhënësve për të zbatuar qasje bashkëkohore, por edhe me kushtet infrastrukturore, teknologjike dhe materiale, mundësitë për zhvillim profesional, si dhe me faktorë që lidhen me nxënësit, prindërit dhe bashkëpunimin profesional.



Përgjigjet e kësaj pyetjeje e përforcojnë rezultatin e pyetjes së parë, duke treguar se mësimdhënia bashkëkohore nuk është ende e përhapur në masë të mjaftueshme në shkollat tona. Vetëm 34% e mësimdhënësve deklarojnë se përdorin TIK-un gjatë orës mësimore, 38% e përdorin herë pas here, ndërsa 28% nuk e përdorin fare, pavarësisht kërkesës ligjore që 30% e orëve mësimore të realizohen me përdorimin e TIK-ut. Këto të dhëna evidentojnë nevojën për forcimin e kompetencave digjitale të mësimdhënësve dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Zhvillimi i teknologjisë dhe përhapja e internetit kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në mënyrën e organizimit dhe realizimit të procesit arsimor, duke e bërë të domosdoshme përshtatjen e mësimdhënies me kërkesat e reja të arsimit. Në këtë kuadër, përdorimi i TIK-ut mundëson rritjen e ndërveprimit, pasurimin e procesit mësimor dhe zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Prandaj, integrimi i teknologjisë nuk duhet të trajtohet vetëm si përmbushje e një kërkese formale, por si një nevojë e arsimit bashkëkohor.



Çdo reformë në arsim duhet të shoqërohet me trajnime, seminare dhe punëtori që u mundësojnë mësimdhënësve të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për zbatimin e ndryshimeve në procesin mësimor. Në këtë drejtim, BZHA, si institucion kompetent për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, ka rol të rëndësishëm në organizimin dhe realizimin e këtyre aktiviteteve.
Rezultatet tregojnë se 18% e mësimdhënësve kanë marrë pjesë në trajnime gjatë këtij viti, 21% vitin e kaluar, 30% para dy vitesh, ndërsa 31% deklarojnë se pjesëmarrja e tyre ka qenë para shumë vitesh ose nuk e kujtojnë saktësisht. Këto të dhëna tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e mësimdhënësve nuk kanë marrë pjesë kohët e fundit në trajnime, çka evidenton nevojën për një qasje më të vazhdueshme dhe më sistematike ndaj zhvillimit të tyre profesional.
Përveç vazhdimësisë së trajnimeve që zhvillohen në nivel shkolle, rëndësi të veçantë ka edhe cilësia dhe zbatimi i tyre në praktikën e përditshme mësimore. Këto trajnime duhet të udhëhiqen nga profesionistë kompetentë dhe të lidhen drejtpërdrejt me nevojat dhe sfidat konkrete me të cilat përballen mësimdhënësit në shkollë. Një rëndësi të veçantë ka edhe bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve, përmes shkëmbimit të përvojave, diskutimit të praktikave të suksesshme dhe reflektimit të përbashkët mbi mënyrat e përmirësimit të mësimdhënies. Në këtë mënyrë, njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë trajnimeve nuk mbeten vetëm në nivel individual, por mund të përcillen dhe të shfrytëzohen nga mësimdhënës të tjerë brenda shkollës. Për këtë arsye, është e nevojshme që shkollat të krijojnë mekanizma më të qëndrueshëm për përcjelljen e përvojave dhe njohurive të fituara gjatë trajnimeve, duke i bërë ato pjesë të zhvillimit profesional të vazhdueshëm të stafit. Si rrjedhojë, trajnimet në nivel shkolle mund të kenë ndikim më të madh në përmirësimin e praktikave mësimore dhe në krijimin e një kulture bashkëpunimi dhe të të nxënit të vazhdueshëm ndërmjet mësimdhënësve.



Hulumtimet dhe praktika bashkëkohore konfirmojnë se një nga mënyrat më efektive për zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve është bashkëpunimi profesional ndërmjet tyre, veçanërisht përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira. Në këtë drejtim,

funksionimi i aktiveve profesionale ka rëndësi të veçantë, pasi mundëson zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive profesionale, përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve, nxitjen e qasjeve inovative dhe forcimin e rolit të mësimdhënësit si nxitës i ndryshimeve.


Megjithatë, rezultatet e pyetjes në fjalë tregojnë se funksionimi i aktiveve profesionale në shkollat tona nuk është në nivelin e dëshiruar. Gjysma e mësimdhënësve të anketuar (50%) deklarojnë se aktivet profesionale funksionojnë pjesërisht, 18% shprehen se ato nuk funksionojnë, ndërsa vetëm 32% konfirmojnë funksionimin e tyre. Këto të dhëna tregojnë nevojën për fuqizimin e rolit dhe funksionimit të aktiveve profesionale, veçanërisht në drejtim të bashkëpunimit, shkëmbimit të përvojave dhe mbështetjes profesionale ndërmjet mësimdhënësve.



Rezultatet e kësaj pyetjeje tregojnë një perceptim të theksuar të politizimit të arsimit në procesin e punësimit të mësimdhënësve të rinj dhe të përzgjedhjes së drejtorëve të shkollave. Konkretisht, 58% e mësimdhënësve të anketuar vlerësojnë se arsimi është shumë i politizuar, 23% se është pak i politizuar, 9% se është i politizuar deri diku, ndërsa 10% shprehen se nuk është aspak i politizuar.

Këto rezultate evidentojnë nevojën për forcimin e parimeve të transparencës, profesionalizmit dhe meritokracisë në proceset e punësimit dhe të përzgjedhjes së drejtuesve të institucioneve arsimore. Përzgjedhja e mësimdhënësve dhe drejtuesve mbi bazën e kompetencave, rezultateve dhe meritave profesionale do të kontribuonte në krijimin e një sistemi më të drejtë dhe më cilësor të arsimit.


Nëse proceset e punësimit dhe avancimit nuk bazohen në kritere profesionale dhe meritokratike, kjo mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e kuadrit arsimor dhe në funksionimin e institucioneve. Për pasojë, ulet motivimi i mësimdhënësve për zhvillim profesional, cenohet besimi në sistem dhe krijohen kushte që në arsim të mbizotërojnë antivlerat siç janë: analfabetizmi funksional, mungesa e të menduarit krijues dhe kritik te nxënësit, marrja e diplomave pa meritë dhe paaftësia e mësimdhënësve për të dëshmuar aftësitë e tyre në praktikën e mësimdhënies, pavarësisht mesatares së lartë të notave në diplomë.“



Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet rajoni i Ballkanit, përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut, është fenomeni i shpopullimit. Pas viteve '90, kur u shpërbë Jugosllavia, një nga kërcënimet kryesore për rajonin ishin tensionet etnike, ndërsa vitet e fundit shpopullimi është bërë një nga sfidat më serioze. Këtë e dëshmojnë edhe rezultatet e hulumtimit: 56% e mësimdhënësve të anketuar deklarojnë se është ulur numri i nxënësve në klasat e tyre, 32% se numri i nxënësve është rritur, ndërsa 12% shprehen se shpopullimi nuk ka ndikuar në numrin e nxënësve.

Faktorët që ndikojnë në rënien e numrit të nxënësve janë të shumtë dhe të ndërlidhur, por ndër më të rëndësishmit janë emigrimi dhe migrimi i brendshëm. Emigrojnë kryesisht të rinjtë, të cilët shpesh krijojnë familje dhe lindin fëmijë jashtë vendit, duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e numrit të fëmijëve në moshë shkollore. Në zonat rurale, përveç emigrimit të jashtëm, ndikim të madh ka edhe migrimi i brendshëm, përkatësisht zhvendosja e popullsisë nga fshatrat drejt qyteteve dhe nga qytetet më të vogla drejt kryeqytetit. Si pasojë, shkollat rurale përballen me rënie të numrit të nxënësve, ndërsa shkollat urbane me mbingarkesë. Kjo pabarazi vërehet edhe në madhësinë e klasave: në shkollat e kryeqytetit, numri i nxënësve në një klasë mund të arrijë 35 - 40, ndërsa në zonat rurale dhe qytetet më të vogla ka klasa me vetëm 5–10 nxënës.

Pasojat e shpopullimit nuk kufizohen vetëm në uljen e numrit të nxënësve, por lidhen drejtpërdrejt edhe me organizimin dhe qëndrueshmërinë e institucioneve shkollore. Numri i ulët i nxënësve në shkollat rurale mund të çojë në vendime për bashkimin e shkollave ose organizimin e tyre në objekte të përbashkëta. Një zgjidhje e tillë, nëse nuk shoqërohet me masa të përshtatshme, mund të ndikojë në cilësinë dhe barazinë e arsimit, veçanërisht për nxënësit e zonave rurale. Në të njëjtën kohë, bashkimi ose mbyllja e shkollave mund të kishte pasoja edhe për stafin pedagogjik, për shkak të mundësisë së zvogëlimit të numrit të vendeve të punës. Në këtë mënyrë krijohet një zinxhir pasojash: shpopullimi ul numrin e nxënësve, ulja e numrit të nxënësve dobëson qëndrueshmërinë e shkollave rurale, ndërsa zvogëlimi i shërbimeve arsimore mund të nxisë më tej largimin e familjeve nga këto zona. Nëse kjo prirje vazhdon pa politika të qëndrueshme demografike dhe arsimore, ekziston rreziku që në një të ardhme jo të largët disa shkolla rurale të humbin funksionin e tyre. Në shtator të këtij viti, si pasojë e rënies së numrit të nxënësve, u mbyllën disa shkolla fillore në Komunën e Strugës, Dellçevës, Tetovës, Bogovinës, Manastirit, duke e thelluar edhe më tej pabarazinë në qasjen ndaj arsimit.



Përgjigjet e mësimdhënësve janë të larmishme, sepse secili nga faktorët e përmendur më lart, kush më shumë e kush më pak, ndikon në rezultatet e të nxënit. Sipas rezultateve të pyetësorit, 24% e të anketuarve mendojnë se rezultatet e dobëta janë pasojë e punës së mësimdhënësve, ndërsa 25% shprehen se rezultatet nuk kanë të bëjnë me punën e mësimdhënësve. Një përqindje më e lartë, 29%, e lidh rezultatet me politikat e gabuara të MASH-it, ndërsa 11% mendojnë se ato janë pasojë e mosfunksionimit të trekëndëshit didaktik. Po ashtu, 24% e mësimdhënësve vlerësojnë se kurrikula nuk është hartuar sipas standardeve bashkëkohore, ndërsa 7% theksojnë se tekstet mësimore janë të papërshtatshme dhe të stërngarkuara me informacion teorik.

Këto rezultate tregojnë se mësimdhënësit nuk e shohin problemin si pasojë të një faktori të vetëm, por si rezultat të ndërveprimit të disa faktorëve. Megjithatë, është paradoksale të mendojmë se mund të arrijmë rezultate të mira në vlerësimin ndërkombëtar PISA, kur ende e zhvillojmë orën mësimore sipas modelit tradicional. Pyetjet e vlerësimit PISA synojnë të matin aftësinë e nxënësve për t'i zbatuar njohuritë në situata të ndryshme, duke nxitur të menduarit kritik, krijues dhe logjik.

Në këtë aspekt, rezultatet e pyetësorit janë një tregues se duhet të rishikohet mënyra se si zhvillohet procesi mësimor në tërësi. Nëse mësimdhënia vazhdon të përqendrohet kryesisht në transmetimin dhe memorizimin e informacionit, nxënësit nuk do të kenë mundësi të mjaftueshme për të zhvilluar aftësitë që kërkohen në vlerësime të këtij lloji. Përmirësimi i rezultateve kërkon që nxënësi të jetë në qendër të procesit mësimor, të ketë mundësi të analizojë, të diskutojë, të argumentojë, të zgjidhë probleme dhe t'i zbatojë njohuritë në situata konkrete (Garo, 2013 : 38).

Prandaj, përgjegjësia nuk mund t'i atribuohet vetëm mësimdhënësit. Rezultatet e PISA-s duhet të shihen si pasqyrim i funksionimit të të gjithë sistemit arsimor, në të cilin ndërthuren puna e mësimdhënësit, kurrikula, tekstet mësimore, politikat arsimore dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjithë faktorëve të procesit edukativo-arsimor.



Duke pasur parasysh rëndësinë e teksteve mësimore, duhet treguar kujdes i veçantë në përgatitjen, përzgjedhjen dhe botimin e teksteve për çdo cikël shkollimi. Kjo detyrë në sistemin tonë arsimor i është ngarkuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Maqedoninë e Veriut (MASh), e cila vitet e fundit është përgjegjëse për botimin dhe përdorimin e teksteve shkollore. Në sistemin tonë arsimor, për disa lëndë, prej vitesh përdoret vetëm një tekst mësimor për të gjitha shkollat e vendit, pa fletore pune dhe pa libër për mësuesin (Dibra Zeqiri, 2022 : 45).
Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara që ofron Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sidomos sa i përket përzgjedhjes dhe përdorimit të teksteve alternative, natyrshëm lind pyetja: A janë tekstet mësimore në përdorim plotësisht në përputhje me kërkesat e kurrikulës? Rezultatet e pyetësorit tregojnë se vetëm 20% e mësimdhënësve të anketuar mendojnë se tekstet mësimore janë në harmonizim të plotë me kërkesat e kurrikulës. Nga ana tjetër, 37% janë shprehur se tekstet nuk janë plotësisht në përputhje me kërkesat e kurrikulës, ndërsa 34% vlerësojnë se janë në përputhje me to vetëm pjesërisht. Pjesa tjetër, 9% e të anketuarve, kanë dhënë përgjigje dhe komente të tjera, të cilat kryesisht lidhen me ndryshimet e shpeshta të teksteve mësimore, mungesën e vazhdimësisë dhe mospërputhjen e përmbajtjeve me moshën dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve.
Këto të dhëna janë mjaft domethënëse, pasi vetëm një përqindje e vogël e mësimdhënësve i konsideron tekstet plotësisht të harmonizuara me kërkesat e kurrikulës. Madje, në komentet e tyre, mësimdhënësit theksojnë se janë bërë shumë eksperimente me tekstet e ciklit të ulët dhe se pothuajse çdo 3–4 vjet ato ndryshohen, gjë që krijon vështirësi jo vetëm për nxënësit, por edhe për vetë mësimdhënësit gjatë procesit të punës. Kjo dëshmon se gjatë hartimit të teksteve mësimore duhet të respektohen më shumë kriteret pedagogjike, didaktike dhe metodike. Një ndër kriteret themelore është përshtatja e përmbajtjes me moshën, nivelin e zhvillimit dhe aftësitë e nxënësve. Teksti mësimor nuk duhet të jetë vetëm një burim informacioni, por një mjet që e lehtëson të nxënit, nxit të kuptuarit, zhvillon të menduarit kritik dhe e orienton nxënësin drejt zbatimit të njohurive. Në këtë kuptim, mospërputhja ndërmjet teksteve mësimore dhe kërkesave të kurrikulës mund të ndikojë drejtpërdrejt edhe në cilësinë e rezultateve të të nxënit. Nëse kurrikula synon zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të nxënësve, ndërsa teksti mësimor përqendrohet kryesisht në përmbajtjen teorike ose nuk u përshtatet niveleve të tyre, atëherë krijohet një hendek ndërmjet kërkesave të kurrikulës dhe asaj që ofron realisht procesi mësimor.

4. Rekomandime

Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi tregojnë se arsimi përballet me probleme dhe sfida të ndryshme, të cilat kërkojnë vëmendje dhe ndryshime konkrete. Përmirësimi i kësaj gjendjeje kërkon angazhim të përbashkët nga të gjithë ata që janë pjesë e procesit arsimor. Nisur nga rezultatet e hulumtimit, kemi propozuar disa rekomandime që mund të ndikonin në përmirësimin e gjendjes:

- ✓ Të ndalohet rreptësishtë përdorimi i celularëve në shkollë.
- ✓ MASh-i duhet të krijojë strategji për të siguruar kushte të barabarta infrastrukturore dhe furnizim me teknologji mësimore, si për shkollat urbane, ashtu edhe për shkollat rurale.
- ✓ Të investohet më shumë në shkollat rurale pavarësisht numrit të ulët të nxënësve, që të mos humbasë edhe ajo shpresë e paktë që u ka mbetur njerëzve. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e migrimit të brendshëm dhe në ruajtjen e funksionimit të shkollave rurale.

- ✓ MASh-i të marrë përgjegjësinë për sigurimin e teksteve shkollore, të shqyrtojë problemet që lidhen me to dhe të garantojë furnizimin e të gjitha shkollave me tekste, në përputhje me detyrimet ligjore, në mënyrë që fotokopjimi të mos përdoret si zëvendësim për mungesën e tyre.
- ✓ Hartimi i teksteve mësimore të bëhet nga një ekip i përbërë nga specialistë, akademikë, dhe mësimdhënës të shkollave fillore e të mesme.
- ✓ Të organizohen takime me mësimdhënësit dhe prindërit për të bashkërenduar veprimet dhe për të shkëmbyer këshilla e propozime.
- ✓ Drejtorët e shkollave të hartojnë strategji që nxisin bashkëpunimin dhe përmirësojnë funksionimin e aktiveve profesionale.
- ✓ Të trajnohen vazhdimisht mësimdhënësit për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënie.
- ✓ Arsimi duhet të funksionojë mbi bazën e parimeve dhe normave pedagogjike dhe të jetë sa më i pavarur nga ndikimet politike. Kjo do të ndihmonte edhe në parandalimin e largimit të kuadrit cilësor.
- ✓ Të ndryshohet mënyra e vlerësimit të nxënësve, duke u dhënë më shumë hapësirë detyrave që matin të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, argumentimin dhe zbatimin e njohurive, e jo vetëm riprodhimin e informacionit.
- ✓ Të krijohen programe të veçanta për zhvillimin e leximit me kuptim, sidomos në ciklin fillor.
- ✓ Leximi nuk duhet të trajtohet vetëm si aftësi teknike, por edhe si aftësi për të kuptuar, interpretuar dhe analizuar tekstin e lexuar.
- ✓ Të përdoren rezultatet e PISA-s jo vetëm për të evidentuar dobësitë, por edhe për të hartuar plane konkrete për përmirësim, zbatimi i të cilave do të ndiqet dhe vlerësohet periodikisht.

5. Përfundime

Arsimi nuk mund të ndërtohet mbi reforma të njëpasnjëshme, pa vazhdimësi, pa vizion të qartë dhe pa një bazë të qëndrueshme profesionale. Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se sfidat me të cilat përballet sistemi arsimor në Maqedoninë e Veriut janë të ndërlidhura dhe kërkojnë një qasje të integruar, afatgjatë dhe të bazuar në nevojat reale të shkollës.

Përmirësimi i cilësisë së arsimit nuk mund të arrihet vetëm përmes ndryshimit të programeve, teksteve apo metodave të veçanta, por kërkon ndërhyrje në mënyrën e mësimdhënies, zhvillimin profesional të mësimdhënësve, kushtet e punës, përdorimin e teknologjisë, cilësinë e kurrikulave dhe teksteve, si dhe në funksionimin profesional dhe institucional të sistemit arsimor. Në këtë vazhdë, rezultatet e PISA-s, veçanërisht në fushën e leximit me kuptim, duhet të shihen jo vetëm si tregues statistikorë apo si renditje ndërkombëtare, por si një sinjal për nevojën e rishikimit të mënyrës se si zhvillohet procesi mësimor.

Rezultatet e dobëta në këtë fushë tregojnë nevojën për një kalim më të vendosur nga mësimdhënia e bazuar në memorizimin dhe riprodhimin e informacionit drejt një qasjeje që zhvillon të kuptuarit, mendimin kritik, krijimtarinë, aftësinë për të argumentuar dhe për të zgjidhur probleme. Nëse synohet që nxënësit të jenë në gjendje t'i zbatojnë njohuritë në situata të ndryshme të jetës reale, atëherë edhe procesi mësimor duhet të krijojë vazhdimisht mundësi për analizë, diskutim, bashkëpunim dhe zbatim praktik të njohurive.

Njëkohësisht, përmirësimi i cilësisë nuk mund t'i ngarkohet vetëm mësimdhënësit. Çdo reformë arsimore kërkon që mësimdhënësi të jetë jo vetëm zbatues i ndryshimeve, por edhe pjesëmarrës aktiv në hartimin dhe zhvillimin e tyre. Për këtë arsye, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, kushtet e përshtatshme të punës, bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve dhe

funksionimi i aktiveve profesionale duhet të trajtohen si pjesë themelore e politikave për përmirësimin e arsimit. Po aq e rëndësishme është që punësimi dhe përzgjedhja e kuadrit arsimor dhe drejtuesve të institucioneve të mbështeten në profesionalizëm, transparencë dhe meritokraci.

Në të ardhmen, politikat arsimore duhet të orientohen drejt një sistemi më të qëndrueshëm, më profesional dhe më të përgjegjshëm, në të cilin rezultatet e vlerësimeve ndërkombëtare, përvoja e mësimdhënësve dhe nevojat e nxënësve të përdoren si bazë për vendimmarrje dhe përmirësim të vazhdueshëm. Në vend të reformave të shpeshta dhe të shkëputura, nevojitet një strategji afatgjatë që siguron vazhdimësi, monitorim të rezultateve dhe rishikim të politikave në bazë të të dhënave dhe dëshmive nga praktika.

Përmirësimi i arsimit nuk është vetëm detyrë e shkollës apo e Ministrisë së Arsimit, por përgjegjësi e të gjithë shoqërisë. PISA mund të na tregojë se ku qëndrojmë, por vetëm vullneti për të ndryshuar mund të përcaktojë se ku duam të arrijmë. Një shtet që investon në arsimin e fëmijëve të tij, investon në të ardhmen e vet, ndërsa një shoqëri që e neglizhon arsimin, rrezikon të humbasë jo vetëm një rezultat në një test, por vetë mundësinë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë.

Referencat

[1]. Dardhishta, H. (2023). Gjuha standarde shqipe në tekstet shkollore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Prishtinë. (https://www.researchgate.net/publication).

[2]. Dibra Zeqiri, F. (2022). Lektyra në shkollat e mesme me mësim në gjuhën shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Stobi Trejd-Dooel, Shkup.

[3]. Dibra Zeqiri, F. (2024). Gjuha dhe shkolla shqipe. Fokus Print, Shkup.

[4]. Garo, S. (2013). Teoria dhe praktika e mësimdhënies. Albania University Press.

[5]. Gjokutaj, M. (2009). Didaktika e gjuhës shqipe. Shtëpia Botuese e Librit Shkollor.

[6]. OECD. (2023). PISA 2022 Results: Country Notes – North Macedonia. OECD Publishing.

[7]. OECD. (2026). PISA 2025 Results (Volume I): Country Notes – North Macedonia. OECD Publishing. https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/repo__rts/2026/09/pisa-2025-results-volume-i-country-notes_88d1164e/north-macedonia_9 4c8bd2b/a0edad53-en.pdf

[8]. Orlich, D. C., Harder, R. J., Callahan, R. C., Kravas, K. H., Kauchak, D. H., Pendegrass, R. A., & Keogh, A. J. (1995). Strategjia e të mësuarit. Eureka.

[9]. Temple, C., Crawford, A., Saul, W., Mathews, S. R., & Makinster, J. (2006). Strategji të mësimdhënies dhe të nxënit për klasat mendimtare. Qendra për Arsim Demokratik (CDE).

[10]. Zwiers, J. (2005). Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6–12: Manual veprimtarish mësimore për inteligjencat e shumëfishta. Qendra për Arsim Demokratik.